Lezhë, më 31.05.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 31.05.2022, në orën 10:00, në sallën e QKF mbi mbledhjen jashtë radhe, të thirrur me kërkesë të kryetarit të Bashkisë, pasi për shkak të procesit të rindërtimit, afati i parashikuar nuk pret dot mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Mbledhja u hap nga Kryetari z. Ernest Rokaj i cili bëri të njohur projekt vendimin për shqyrtim që është "Për dhënien e pëlqimit për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet fondacionit "Firdeus" dhe Bashkisë Lezhë për ndërtimin e seksionit 1, të pallatit 71 (ish BKT), në lagjen "Besëlidhja", rruga "Luigj Gurakuqi", të qytetit të Lezhës".

- Kërkoi fjalën z. Agostin Marku.

Agostin Marku: Se ke të drejtë kryetari i Bashkisë për të thirrosë mbledhje jashtë radhe, kjo dihet. Ju z. Kryetar, pse nuk zbatoni procedurat e thirrjes së mbledhjes jashtë radhe?

Ernest Rokaj: M'i trego procedurat që nuk kemi zbatuar.

Agostin Marku: Afatet ligjore

Ernest Rokaj: Sa është afati ligjor? Është 48 orë.

Agostin Marku: Kur kemi dalë shkresat e Bashkisë? Më 30 maj. Me se jemi sot, m'i pak orët. Në emër të emergjencës, në emër të problemeve sociale, mos shkel procedurat e thirrjes së mbledhjes jashtë radhe.

Ernest Rokaj: ke të drejtë.

I japim fjalën ZV/Kryetarit të Bashkisë z. Ermal Pacaj.

Ermal Pacaj: Faleminderit z. Kryetar.

Që nga mbledhja e parë pas 26 Nëntorit kur ra tërmeti, kemi pasë dakordësuar me Këshillin, që për sa i përket projekt vendimeve që kanë të bëjnë me rindërtimin, ne mund të mblidhemi edhe në 10:00 të darkës, po të jetë nevoja. Përtej pjesës burokratike, se absolutisht jam dakord me Gustin, por jam dakord edhe me Kryetarin e Këshillit. Kjo është një histori emergjence sepse kështu erdhën punët. Kryetari i Bashkisë kërkoi që mbledhja të thirrej sot për nesër. A është kundër me proceduren, thoni ju, jeni apo s'jeni dakord por ky që kemi sjellë sot është një projekt vendim që besoj që i ka vënë kapakun një historie shumë të gjatë që ndodh me procesin e rindërtimit në Bashkinë e Lezhës, për atë objekt sepse fillimisht, ai ka qenë objekti i parë që është shpallur i pabanueshëm në Bashkinë e Lezhës. Edhe i pari që i ka ardhur akt ekspertimi i thelluar nga Instituti i Ndërtimit dhe është pallati i parë që ne kemi kaluar në Këshill. Gjithashtu është pallati i parë për të cilin u bë marrëveshje me shoqatën bamirëse "Jetimat e Ballkanit", e cila mori përsipër

ndërtimin edhe të pallatit që ne i themi i BKT-së, që në fakt është pallati 71 që është i ndarë në dy seksione 1 dhe 2 por 2-shi sipas vlerësimit të thelluar nuk doli për t'u shembur, edhe të pallatit 88, edhe shtëpitë individuale në Shehër kryesisht se janë edhe dy në Rrugën Skënderbeg.

Marrëveshja që u nënshkrua mes "Jetimat e Ballkanit" dhe qeverisë shqiptare mori formë. Ata bënë projektet por duke parë mundësinë se PDyV e pikëzuar, që juve jua kemi sjellë në Këshill për ta miratuar, nuk e lejonte që pallati të ndërtohej më shumë se 7 kate. Pastaj ne pritëm një VKM të posaçme e cila hodhi në fuqi PDyV dhe plani i detyrueshëm vendor dhe pastaj një 7 kate që ishte ne e quam B-P kate ~~sepse~~ pallatet Besëlidhja atje mungonte hapësira dhe për këtë shkak Fondi i Zhvillimit mendoi që të ndërtohej edhe BKT-ja dhe na hapi një marrëveshje "Jetimave të Ballkanit" për ta ndërtuar Fondi i Zhvillimit. Pastaj kur u ndryshua PDyV doli hapësira që aty të ndërtohej 97 apartamente te lagjja "Besëlidhja" dhe nuk ishte nevoja këtu për të bërë pallat më të madh. Sipas Fondit të Zhvillimit aty ku është pallati BKT, do ndërtohej pallat 8 kate që me plotësu nevojat edhe të pallatit tjetër, por për faktin se ata u

stabilizuan atje ngeli pastaj vetëm ky, pa u ndërtuar. Fondi kishte bërë marrëveshjet dhe nuk e kishte parashikuar si fond.
Ne si bashki i bëmë kërkesë Këshillit të Ministrave (KSHR-së → Këshillit Shtetëror të Rindërtimit) për të financuar këtë objekt me palë kontraktuese Bashkinë Lezhë.
Kjo pengoi pak gjatë pa marrë përgjigje, derisa përgjigje definitive ishte që fondacioni "Firdeus" i cili kishte një marrëveshje me qeverinë shqiptare, për rindërtimit, kishte një pjesë fondi të pa ezauruar, te 1,5 mln euro, dhe mbasi i bëmë kërkesën dhe ata u njohën me preventivin, shprehën dakordësinë për të ndërtuar këtë objekt. Kryetari ka insistu që çdo pyetësor të marrë metrat që ka pasë. Vetëm kështu ne mund të arrinim marrëveshjen për pallatin, siç ka pasë, me metrat siç ka pasë. dhe secili të kompensohet në bazë të Aktit Normativ Nr. 9, që të fitojnë metrat që kanë pasë. Nuk do e realizonim dot po t'i futeshim pjesës së përfitimit sipas numrit të anëtarëve të familjes.
Ne kemi përpiluar një draft kontratë që e kemi bashkëlidhur me projekt vendimin dhe kemi ditur e menduar të caktuar që t'u çojmë marrëveshjen të firmosur. Ne nuk e firmosim dot marrëveshjen, pa marrë pëlqimin e Këshillit. N.j.s.s ky p/vendim kalon sot,

dhe Prefektura të konfirmojë sot dhe është
gati për nesër, atëherë ne duhet të shkojmë
nesër mbasdite atje, të lidhim kontratën
me "Firdeus"-in që punët të fillojë menjëherë.
Domth është projekti i përfunduar, fjitlugke
është e përfunduar, vetëm për të filluar.
Për këtë është edhe ngutja.
Agostin Marku: Së pari, neni 53 për ZV/Kryetarin
e Bashkisë për thirrjen e mbledhjes, në çdo
rast 5 ditë para, që të jemi të portë.
Së dyti, për marrëveshjen. Unë shoh një
marrëveshje shumë të thatë, që nuk ka
asnjë term financiar, as asnjë efekt
Ndoshta e kemi nga halli, siç thatë ju,
por diku flet apartamenti sipas figurave,
diku thua sipas sipërfaqes.
Pra, këtu ka të bëjë me diskriminim ndaj
qytetarëve që kanë të njëjtin problem
Tani, se si zgjidhet ana financiare, këtë
duhet ta përcaktoni ju
Për këto gjëra do ju lindin juve probleme nesër.
Ermal Pacaj: kam një përgjigje për të tria
pyetje e para, për pjesën e thirrjes së këshillit
e etaurova.
E dyta, pjesa e asaj që ka mungon te kontrata
dhe relacioni shumë i thatë që ju kemi sjellë,
aty është një marrëveshje e cituar me nr. 4140 prot,
dt. 12.08.2020, fondacioni "Firdeus" ka një
marrëveshje me qeverinë shqiptare, ku ka të

përcaktuar gjithçka. Marrëveshja që ne kemi është si nënmarrëveshje që ai bën me bashkitë se ai nuk e ka marrëveshjen me Bashkinë e Kotës, e ka marrëveshjen me qeverinë Shqiptare.

→ Erdhi këshilltari Redi Brunga

→ Ermal Pacaj: Për sa i përket pjesës së diskriminimit që thua ti, pse këta kështu, pse këta ashtu, po, pallatet te Gurrat, dhe pallatet te lagjja "Besëlidhje", kur janë porositur për t'u bërë, fatmirësisht, në pallate lagj. Besëlidhje, unë nuk di një familje që të kotë marrë një metër më pak, Pallatet te "Besëlidhje" dhe te "Gurrat" janë porositur që në qershor 2020, që 7 muaj pasi ka rënë tërmeti

→ Doli këshilltari Argjentjana Noka

→ Ermal Pacaj: Këtu komplet bazë tjetër ligjore. Duke pa dinamikën që ka pasë, edhe hapësira ligjore ka ndryshuar. Prapë vazhdon e ndryshon. Ne po presim që të dalë një VKM tani, që i jep të drejtën qytetarit që i është prishur shtëpia individuale, i cili nuk ka dokument pronësie Dinamika e ka bërë që të rregullohen disa herë aspektet ligjore, se po të mirrim ~~në fuqi~~ VKM Nr. 5, Akti Normativ Nr. 9, dhe mos të ndryshonte asgjë në to, sot asnjë shtëpi nuk do e bënim.

Sepse kishte kaq-kaq problematikash që do ishin bërë përgjegjësi

Ernest Rakaj: E kalojmë në votim projekt-vendimin mbasi nuk ka diskutime të tjera. Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (21 këshilltarë).

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
Ernest Rakaj